

# RELACION TEKNIK

**PER PROJEKT –ZBATIMI**

**OBJEKTI: “KANALIZIMI I UJRAVE TE ZEZA LAGJA TAFAN”**

**-BASHKIA BELSH-**

**TIRANË**

## TE PERGJITHSHME

### **Pozicioni Gjeografik**

Objekti: " Studim Projektim i Rrjetit te Kanalizimeve te Ujrave te Zeza Lagja Tafan ", Bashkia Belsh.

Zona qe merret ne studim shtrihet ne anen lindore te qendres se qytetit .

**Bashkia e Belshit** shtrihet në zonën e Dumresë, në një zonë që shquhet nga numri i madh i liqeneve dhe me një peizazh tërheqës,

Belshi është një qytet i vogël buzë liqenit me të njëjtin emër, kryeqendra tradicionale e zonës së Dumresë.

### ***Kushtet klimaterile te zones:***

Kushtet klimaterike te zones karakterizohen nga nje klime mesdhetare e kontinentale pergjithesishr e lagesht dhe jo e ftohte ne dimer dhe me vere te nxehte dhe te thate. Temperatura mesatare maksimale varion nga  $11^{\circ}\text{C}$  ne janare deri ne  $31.2^{\circ}\text{C}$  ne korrik. Temperatura mesatare minimale varion nga  $2.2^{\circ}\text{C}$  ne janare deri ne  $15.8^{\circ}\text{C}$  ne korrik. Temperatura minimale absolute eshte rregjistruar -  $7.5^{\circ}\text{C}$  dhe ajo maksimale absolute  $42^{\circ}\text{C}$ .

Ngricat jane krvesisht ne muajr dhjetor-shkurt, qe rralle here mund te kete shtrese akulli e cila nuk i kalon 3 cm.

Temperatura mesatare e ajrit varion nga  $6.7^{\circ}\text{C}$  ne janare deri ne  $23.4^{\circ}\text{C}$  ne korrik.

### ***Kushtet ambientale:***

Nga pikpamja urbane zona ku projektohen kanalizimet e ujrave te zeza ka nje popullesi prej 700 banore, pra zona karakterizohet nga nje dendesi mesatare popullsie si rezultat i ndertimeve te shumta. Nje nga problemet me thelbesore qe nuk eshte zgjidhur definitivisht eshte infrastruktura e pandertuar ne kere zone.

### ***Gjeologjia e zones:***

Perberja gjeologjike e formacionit tokesor ku do te ndertohen kanalizirnet dhe parametrat gjeologo-inxhinierike dhe gjeoteknike jane tokat të tipit “të hirta, kafe livadhore “dhe “livadhore të hirta kafe“.

### **GJENDJA E INFRASTRUKTURES EKZISTUESE, KANALIZIMEVE**

*Zhvillimi urban:* Zona ne fjale karakterizohet nga nje zhvillim urban i detajuar dhe i kontrolluar me perjashtim te rasteve sporadike te ndertimeve pa leje. Ndertimet jane ekzistuese qe para viteve '90, dhe jane tipike ndertime me ndertesa 2-3-4 kateshe te sistemuara, po keshtu ka pater dhe vazhdojne ndertimet dhe pas viteve '90, ndertimet jane rritur ne menyre te ndjeshme.

*Gjendja e sistemit te kanalizimeve:* Nga zhvillimi urban i zones ,pervec rritjes se prurjeve te shkarkimit si rezultat i rritjes se numrit te popullise, kemi dhe prurje nga rritja e aktiviteteve tregtare ne zone.

Ndertimet e reja kane rritur gjithashtu prurjet e ujrave te zeza. Persa i perket rrjetit te kanalizimeve te ujrave te zeza ne zonen qe po studjohet nuk ekzistojne kjo e konfirmuar nga perfagesuesit e bashkise Belesh dhe nga kqyrja ne vend e zones qe po projektohet.

Zgjidhja e shkarkimit te kanalizimeve te ujrave te zeza aktualisht sot nga banoret eshte zgjidhur duke iprovizuar gropa septike ose i shkarkojne tek kanalet e hapura te ujrave te bardha. Kjo zgjidhje eshte bere nga banoret per shkarkimin e ujrave te zeza, duke mos patur zgjidhje tjeter.

Pika e shkarkimit eshte percaktuar nga ana e bashkise dhe do te lidhet me rrjetin ekzistues me tub betoni Ø1000 (shih planimetrine).

### **PRURJET LLOGARITASE TE UJRAVE TE ZEZA**

Lagja Tafa aktualisht zona që kemi përfshirë në projektin e kanalizimit ndodhet ne territor te Bashkise Belsh dhe sot ka nje popullsi prej afro 700 banoresh, numer i cili pas 25 vjetesh llogaritet me ane te formules se me poshtme:

$$N_n = N (1+0.01*p)^n = 700( 1 + 0.01 *2)^{25} = 700* 1.64= 1148 \text{ banore}$$

Ku:

- $N_n$  : Nr. i banoreve pas n – vjetesh ( n=25 vjet)
- n : Nr. i viteve qe merren parasysh ne llogari
- p : Rritja vjetore e popullise ne perqindje 2%
- N : Nr. aktual i banoreve

Konsumi Shtepiak	170 l/dite/banore
Konsumi Publik	30% e konsumit total
Konsumi Total	243 l/dite/banore

### LLOGARITJA E PRURJES MAKSIMALE

$$Q_{\max} = n * m * k_0 / 24 * 3600 = 1148 * 243 * 2.5 / 24 * 3600 = 8.071 \text{ l/sek}$$

$$Q_{\max} = 8.1 \text{ Lit/ sek}$$

### LLOGARITJA E KOLEKTORIT KRYESOR

Duke pasur parasysh materialin topografik te zones, kolektoret kryesore jane llogaritur me  $i = 4-100 / \text{mije}$  ku nga tabela per seksion rrethor D e brendshme = 800 mm dhe mbushja  $H/ D = 0.6$  per pjerresi minimale 4/ mije pasqyron nje prurje prej 3.33 lit/sek dhe shpejtesi  $V = 0.74 \text{ m/s}$ . Pra sic verehet nga tabela ky seksion kalon disa here prurjet e perlllogaritura me minimumin e pjerresise te gjithe Lagjes Tafan. Perfundimisht zgjedhim Tub betoni, me,  $D_j = 800 \text{ mm}$ . Qendrueshmeria e tubit 8 KN/m<sup>2</sup>

### LLOGARITJA E DEGEZIMEVE

Persa i perket degezimeve, perfundimisht, pranojme Tub betoni

$$D_j = 200 \text{ mm.}$$

Mbasi me kusht teknik nuk mund te merret me diameter me te vogel se 200 mm.

Degezimet ne kolektorin kryesore ne te gjitha pusetat te vendosen lidhjet per degezimet ne fakt e ne perspektive me tuba betoni  $D_j = 200 \text{ mm}$ .

**Qellimi i Punes:** Per realizimin e projektit projektuesi duhet te rishikoje te gjithë informacionin ekzistues lidhur me projektin qe duhet te hartoje, per KUZ sipas detyres se projektimit, dhe te konsultohet me Bashkine Belsh.

### Kanalizimi i Ujrave te Zeza Linja Kryesore

Do te ndertohen me tuba betonarme Ø800mm, Ø600mm, Ø500mm.

### Kanalizimi i Ujrave te Zeza Linja Dytesore

Do te ndertohen me tuba betonarme Ø400mm, Ø300mm, Ø200mm.

1. Linja Kryesore e KUZ-s me diameter te tubave Ø800mm, Ø600mm, Ø500mm do te ndertohet ne sipas vizatimeve te paraqitura.
2. Linja dytesore Ø200mm- Ø400mm do te ndertohet ne te gjithë lagjen me gjatesi sic tregohet ne figure.
3. Vendosja e pusetave mbledhese jo me larg se 50 ml nga cdo banese.
4. Parashikimi i punimeve si nenshtresa zhavori e betoni ne ndertim ,furnizim e vendosje tuba betoni me gote si dhe parashikimi i ndertimit, ne prespektiv mbi keto linja.
5. Te gjitha rruget qe do te prishen do te kthehen ne gjendjen e mepareshme.

Kjo KUZ do te llogaritet per nje periudhe prej 25 vjetesh me nje rritje te popullsise prej 2% ne vit

**A U T O R**  
**STUDIO "ZENIT 06" sh.p.k**  
**ADMINISTRATORI**  
**Ing. Rexhep TARBA**